



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:085014  
Datë: 20.05.2024  
Numri i dokumentit: 05709510

**K.Dh.Sh II.nr.194/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbare të kreditorit “Konstruktori Ing 1969” sh.p.k, me nr. unik identifikues 810502915, me seli në Prishtinë, rr. “Vëllezërit Fazliu” nr. 1, kundër debitorit Komuna e Podujevës, me seli në Podujevë, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2609/22 të datës 07.11.2023, me datë 20.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Podujevës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2609/22 të datës 07.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2609/22 të datës 07.11.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar propësimin e debitorit Komuna e Podujevës, ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbare P.nr.608/22 të datës 24.11.2022, i lejuar nga Përmbaresi Privat Destan Bujupaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2609/22 të datës 07.11.2023.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqit kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Konstruktori Ing 1969” sh.p.k, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm Faturë nr.0212211 e datës 02.12.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit të papaguar nga fatura e lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 15,928.33 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, në vit, sipas LMD-së si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, duke theksuar se nga shkresa e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Fatlum Osmani shihet se debitori nuk ka detyrime ndaj kreditorit duke u bazuar në kontratë dhe kushtet e saj. Ka shtuar se urdhri për përmbartim është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së ngase nuk i përmban në mënyrë komulative të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 29 par.3 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet në tërësi urdhri për përmbartim.

Kreditori në përgjigjen në prapësimin të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar duke deklaruar se fatura është në origjinal, e pranuar dhe protokolluar nga debitori si pranues i shërbimit dhe fatura është e deklaruar në ATK si faturë e rregullt, andaj qëllimi i debitorit është vetëm shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit që ka

ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj në tërësi prapësimin si të pa bazuar ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi si urdhër i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2609/22 të datës 07.11.2023 e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Podujevës, ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.608/22 të datës 24.11.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se e dokumenti – Faturë nr. 0212211 e datës 02.12.2021, në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi, i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Kjo gjykatë vlerëson se fatura si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, është pranuar nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga formulari për kërkesë me nr. prot. 04-442/01-0105962/21 e datës 03.12.2021 e lëshuar nga debitori me rastin e dorëzimit të kërkesës për pagesë të faturës nr. 0212211 nga kreditori, e të cilës kërkesë i është bashkangjitur edhe fatura e lartcekur. Andaj, pranimi i së njëjtës nënkupton që debitori ka pranuar detyrimin që buron nga fatura andaj edhe konsiderohet si dokument i besueshëm.

Gjykata vlerësoj pretendimet ankimore të debitorit se nga fatura nr.021221 e datës 02.12.2021 nuk figuron askund borxhi i kërkuar prej 15.928,33€ por që pretendimin në fjalë e vlerësoj si të pabazuar për faktin se nga pasqyra e llogarisë bankare e kreditorit e datës 18.11.2022, rezulton se shuma totale e paguar nga debitori për kreditorin sipas këtij projekti arrin vlerën prej 192,772.34 EUR, ashtu që diferenca e papaguar për kreditorin është në vlerë prej 15,928.33 EUR, shumë kjo e cila është kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarim.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.Dh.ShII.nr. 194/24 datë:10.05.2024

**Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri**